



**BASHKIA MIRDITË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3242/2 Prot.

Rrëshen më, 05 . 10 . 2020

**V E N D I M**

**Nr. 93 datë 30.09.2020**

**PËR**

**EMËRTIMIN “SHESHI MARIE TUCI”, PARA KATEDRALES NË QYTETIN RRËSHEN, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, 4601, BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, pika 1/1.7. shkronja “b” e nenit 54, shkronja “ll” e nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pikave 1, 3 dhe 4 të nenit 1/1, nenit 3 të ligjit nr 9270 datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” (të ndryshuar), shkronja “dh” të pikës nr. 2 të nenit nr. 11 të ligjit nr. Nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, *si dhe bazuar në kërkesën e Dioqezës së Rrëshenit nr. 3242 prot, datë 29.09.2020*, bashkëlidhur projekt-vendimit të paraqitur nga kryetari i bashkisë në këshillin bashkiak, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak në seancë;

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë emërtimin “SHESHI MARIE TUCI”, para Katedrales në qytetin Rrëshen, njësia administrative Rrëshen, kodi postal 4601, Bashkia Mirditë.
2. Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të zbatojë procedurën për emërtimin në Gjeoportalin ASIG dhe në Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA) sistemi Adresari.
3. Çdo vendim i mëparshëm që bie ndesh me parashikimet e pikës 1 të këtij vendimi shfuqizohet.
4. Ngarkohet kryetari i bashkisë, (drejtorja e planifikimit, zhvillimit të territorit dhe strehimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

*Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (të ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

**SEKRETAR**

**Gasper TOPOLLAJ**



**KRYETAR**

**Pjeter PJETRI**